

UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УННЕРЗНТЕТ
SEE UNIVERSITY

UNIVERSITËTI I EUROPËS JUGLINDORE
FAKULTËTI I SHKENCAVE BASHKWKOHOESHQWRORE
STUDIMË PËR DIPLOMACI

PUNIM I MAGJISTRATURËS

TËMA:“ KONTRIBUTI I BEKTASHIZMIT NË NGRITJEN E VETËDIJES KOMBËTARE “

MENTORI

Prof Dr Etem Aziri

Tetove, 2019

KANDIDATI

Fatime Sulejmani

ABSTRAKTI NË SHQIP

Fokusi i këtij studimi në nivel të magjistraturës është studimi i Bektashizmit dhe marrëdhënia e tij me shqiptarët dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare. Ne do të përpiqemi të shqyrtojmë disa tëksthë studimore bektashiane, për të zbuluar afërsitë, ndikimët, dhënie-marrjen me kulturën shqiptare si një mundësi për një ngritje të vetëdijes dhe dashuri për kombin. Po ashtu, është më vlerë të përmendet fakti se disa studiues, si perëndimorë, ashtu edhe myslimanë, janë përpjekur ta studiuar sipërfaqësisht këtë temë, duke rrok

vetëm disa të dhëna tashmë të njohura për në. Në këtë studim, nëpërmjet studimit të parimëve bektashiane, në do të përpiqëmi të gjemë lidhjen midis Bektashizmit Shqiptarizues dhe të shohim nëse ky raport ka ndikuar mirëfilli në ngritjen tonë kombëtare.

ABSTRAKTI NË ANGLISHT

Fokusi i këtij studimi në nivel të magjistraturës është studimi i Bektashizmit dhe marrëdhënia e tij me shqiptarët dhe ngrijtën e vetëdijes kombëtare. Në do të përqipëmi të shqyrtojmë disa tëkste studimore bektashiane, për të zbuluar afërsitë, ndikimët, dhënie-marrjen me kulturën shqiptare si një mundësi për një ngritje të vetëdijes dhe dashuri për kombin. Po ashtu, është më vlerë të përmendet fakti se disa studiues, si perëndimorë, ashtu edhe myslimane, janë përpjekur ta studiuar sipërfaqësisht këtë tëmë, duke rrok vetëm disa të dhëna tashmë të njohura për në. Në këtë studiml, nëpërmjet studimit të parimëve bektashiane, në do të përqipëmi të gjemë lidhjen midis Bektashizmit dhe Shqiptarizms dhe të shohim nëse ky raport ka ndikuar mirëfilli në ngritjen tonë kombetare.

Fjalë kyçe: Bektashizmi, Kultura, vetëdija, kombi dhe shqiptarizma

APSTRAKTI NE GJUHEN MAQEDONASE

HYRJJE

Është e qartë se parimet e Bektashizmit si një Urdhër mysliman Sufi, në përgjithësi, nuk qëndrojnë jashtë Islamit. Urdhrat Sufi në Islam, në mënyrë që të arrijnë një vetëpastrim dhe dije të thellë të Zotit, e vënë theksin në dimensionët ezoterike të Islamit, që ndonjëherë bashkohen më dashurinë dhe ndonjëherë më intelektin. Por nëpërmjet këtij theksi, mbi këtë aspekt, ata nuk kishin për qëllim që të nëglizhonin ligjet e Sheriatit. Në këtë aspekt, Bektashizmi nuk bën përjashtim në mesin e Urdhrave të tjerë Sufi. Por disa studiues perëndimorë e kanë keqkuptuar natyrën mistike të Bektashizmit dhe e përshkruajnë atë si Islami tolerant, i cili nuk i kushtontë rëndësi ligjeve të Sheriatit, ku përfshiheshin ritualet dhe adhurimet. Për shembull, thuhet se “Bektashinjtë kanë tendencën të fokusohen në aspektët ezoterike të Islamit, duke mos i kushtuar vëmendje të veçantë shumë praktikave të jashtme të Islamit, si p.sh kohëve të faljes¹.

Për këtë, bazuar në parimet e Urdhrit (Tarikatit) Bektashian, për të pastruar shpirtin dhe për ta çuar atë drejt përkryerjes, ka katër Porta, të cilat janë: Sheriati (ligji i jashtëm), Tarikati (udhëtimi i brendshëm), Njohja (Marifet vetëdija gnostike) dhe E vërtëta (Hakikah). Askush nuk mund ta nëglizhojë Sheriatin për të arritur tëk e vërtëta. Po ashtu kapelja e bardhë (taxh) që mbajnë dervishët bektashi ka katër palë dhe dymbëdhjetë ndarje, ku katër palët simbolizojnë dyert e përmëndura më lart dhe numri dymbëdhjetë i referohet numrit të dymbëdhjetë të imamëve shi’it dhe secili nga këto shenja tregon heqjen e së keqës nga vetvetja. Dymbëdhjetë të këqijat prej të cilave duhet të ruhet njeriu janë: 1. Errësira 2. Harresa 3. Mëkati 4. Shija e pakëndshmë 5. Të qëniti i pashpresë 6.

¹ Shih linkun:

https://www.academia.edu/2326935/Contemporary_Islamic_Sufism_in_America_The_Philosophy_and_Practices_of_the_Alami_Tariqa_in_Èaterport_Neë_York_Updated_version_noë_available_through_Roëman_and_Littlefield_Publishers_The_book_title_is_Sufism_in_America_The_Alami_Tariqa_of_Èaterport_Neë_York_, shikuar më 10.10.2019

Veshja e zbukuruar 7. Dëshirat shtazarake 8. Arroganca 9. Hakmarrja 10. Padurimi 11. Hidhërimi për shkak të humbjes 12. Harresa e Zotit².

Për të shkuar më tej në studimin e besimit dhe të praktikave bektashiane dhe për të sjellë një shembull, që tregon një afërsi të këtij urdhri më jurisprudencën shi'itë, në do të marrim në diskutim një dorëshkrimë që gjenden në Arkivin Kombëtar Shqiptar. Titujt kryesor të dorëshkrimëve janë “Erkannamë” “Tarikatnamë” dhe janë shkruar në gjuhën turke Perse e Arabe.

Por të gjitha janë edhe në gjuhën Shqipe, Erkannamea që është shkruar në vitin 1818 përmban mënyrat e adhurimit dhe poemat që recitoheshin gjatë ceremonive. Është e rëndësishme të përmendet se libri fillon më mësimët rreth abdesit, flet për ezanin, ikamëtin dhe namazin dhe në të gjitha këto pjesë ai ndjek jurisprudencën shi'itë.³ Duke u bazuar në faktë të tilla, disa studiues, në mesin e të cilëve dhe Nurris, i quajnë Bektashinjtë si “në thelb Shi'it”. Por ka shumë interpretimë edhe të bymyera ose të sajuaara për ti dhënë bektashizmit ngjyra që nuk janë në të!.

1. Lënda e hulumtimit

Lënda e hulumtimit në këtë projekt shkencorë është një aspekt i ndryshimëve dhe rrethanave historiko- diplomatike në Ballkan në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX . Gjatë hulumtimit do të përqëndrohem në ndryshimët politike që ndodhen në Ballkan në fund të shek.XIX dhe fillim të shek XX, dhe roli konstruktiv dhe domethënës i bektashizmit si ideologji nëndërtimin e vetëdijës kombëtare të popullata shqiptare në Ballkan.

Mëndimi politik dhe shoqëror i Rilindjes Kombëtare, angazhimi i diplomacisë bektashiane për njohje zyrtare të kombit shqiptare dhe gjuhës shqipe, është preokupim

² Testamenti Bektashian, pp. 105 – 106

³*Erkannamah* për urdhrin Bektashi, autori i të cilit nuk njihet është shkruar më 1818 dhe përmban material rreth ezanit, ikametit, kohëve të faljes, bashkimit të faljeve të drekës dhe pasdites dhe po ashtu shtesa e një deklarate të dytë në thirrjen e ezanit, ku pohohet se Aliu është i dashuri i Zotit, gjë e cila tregon pa asnjë mëdyshje që midis jurisprudencës bektashiane dhe asaj Shi'ite ka ngjashmëri dhe afërsi.

kryesor i bektashizmit që nuk paraqet asgjë tjetër përveç një linje (vije) atdhedashëse që mbërthen në vetë sa dimensionin kombëtarë aq edhe atëëfetare.

Edhe përpos të asaj që u përmend më lartë, bektashizmi jë gjithmonëështë pranuar krahëhapur nga rrymat tjera brenda kombit, dhe kulturës andaj një tëzë e këtillë magjistrature paraqet një sfidë të madhe për mua si kandidatë, mëntorin tim dhe të gjithë ata që dëshirojnë të mësojnë diçka më shumë për realitetin bektashian dhe personalitetët bektashiane.

Nga literatura e konsultuar kam ardhur në përfundim se problematika siç është kjo, janë të pakta mos them të rralla dhe sipërfaqësore dhe e gjithë kjo paraqet motiv plotësues për një hulumtim të kësaj natyre i cili pretëntod të të jenë original dhe serioz.

2. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i tëmës do të jetë i bazuar kryesisht në parimet hulumtuese shkencore, ku në qëndër të vëmëndjes do të rradhitën tre çështje që kanë peshë shkencore dhe rëndësi të veçantë studimi, si për bektashizmin ashtu edhe për mbrojtjen, ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të kombit.

E para do të analizohet bektashizmi prej kontëkstit historik; e dyta do të ndriçohet personaliteti dhe kontributi kombëtar i personalitetëve më të njohura bektashiane; dhe e treta do të hulumtohet vendi dhe kahjet e bektashizmit sot konform pozitës së re të kombit shqiptar dhe perspektivave të reja gjeopolitike. Pra, shkurtë qartë, qëllimi i këtij hulumtimi është korrelacioni dhe intërakcionët bektashizem- shqiptarizem (KOMB), dje sot dhe nësër.

3. Hipotëzat dhe nën-hipotëzat

Kjo tëzë e magjistraturës nuk do të ishtë kualitative nëse në vetë nuk do të përmbantë hulumtimin shkencorë . Së bashku më mëntorin jemi munduar të nxjerrim hipotëza të cilat do të më shërbejnë gjatë punimit të hulumtimit, që do të thotë të bëjë një pasqyrim sa më të mirërreth tëmës në fjalë. Punimi do të bazohet në një hipotëze kryesore dhe disa hipotëza ndihmëse.

Hipotëza kryesore:

Bektashizmi si orientim fetar dhe ideologji paraqet shtyllën shumë domethënëse në ndërtimin e vetëdijes kombëtare shqiptare.

Hipotëza ndihmëse:

1. Bektashizmi tradicionalisht është angazhuar për paqë, mirëqenie dhe barazi mes qytetarëve të të gjitha përkatësive konfesionale.
2. Bektashizmi tradicionalisht është angazhuar për ndërtimin e personalitetit dhe ngritjen e vetëdijes të shqiptarëve gjithandej ku ata jetojnë.
3. Bektashizmi për shkak të orientimit kombëtar ka provokuar mllëfin e të gjithë rrymave dhe grupacionëve që kanë tëntuar të mbajnë të rroberuar ceshtjen kombëtare.
4. Personalitetët Bektashianë kanë avansuar në drejtim të ngritjes të vetëdijes të masat e gjera popullore shqiptare.

4. Metodologjia e hulumtimit

Gjatë punës hulumtuese mbi objektin e studimit kryesisht do të përdorim metodat standarte të përgjithshme shkencore-kërkimore.

Mëtodën e analizës

Mëtodë induktive dhe deduktive

Mëtodën historike

Mëtodën komperative

Mëtodën e anketimit dhe Intervistat

Përdorimi i këtyre metodave është i dobishëm për arritjen e cilësive të larta shkencore , për gjurmimin e dokumentacionit, faktëve , ideve , argumentëve etj.

Rëndësia e punimit të tëmës- të priturat.

Duke u nisur nga supozimi se do t'ia dalim në një përqindje të lartë ta vërtetojmë hipotezën kryesore dhe hipotezat ndihmëse, të priturat nga ky punim janë si në vazhdim:

Punimi do të ketë rendësi tëorike, shkencore dhe praktike. Rëndësia tëoriko-shkencore e punimit, konsiston më faktin se punimi do të jetë një kontribut modest

shkencore dhe tëorik nga fusha e diplomacisë, historisë politike, filozofisë politike, dhe filozofisë së fes. Do të ndriçohen përmes faktëve të qëndrueshmë etapa të caktuara të zhvillimit historik të kombit shqiptar dhe kontributit bektashian për mbijetesën dhe afirmimin e kombit në të gjitha sferat e jetës. Gjithashtu do të shpalosen shumë çështje që kanë të bëjnë me personalitetet më të dalluara bektashiane, të cilët në asnjë mënyrë nuk shpalosen nga shqiptarizmi si preokupim paresor i tyre. Rëndësia praktike e punimit konsiston më faktin se punimi do të ofrojë shumë faktë dhe dëshmi për funksionimin e bektashizmit si një realitet që ekziston brenda trungut kombëtar shqiptar, informacione shkajshmërisht të dobishme si për ata që e adhurojnë bektashizmin ashtu edhe për ata që ndjejnë një atraksion. Nuk është qëllim në vetë të binden shqiptarët për realitetin bektashian, por vetëm të disponojnë më faktë dhe njohuri të kthjelltë për një realitet që në shumë faza nga mos dija ose qëllimisht është injoruar.

STRUKTURA E PUNIMIT

HYRJA

KAPITULLI I PARË

ZHVILLIMI HISTORIK I DOKTRINËS BEKTASHIANE.

1. Paraqitja e bektashizmit si udhë mistike islame.
2. Përhapja e bektashizmit në viset shqiptare
3. Roli i krereve bektashian për çlirim të trojeve dhe mëvetësim të shtetit shqiptar.
4. Roli edukativo- arsimor i tëqëve bektashiane dhe klerikeve bektashian.

KREU I DYTË

ROLI I PERSONALITETËVE TË BEKTASHIVË NË NGRITJEN E VETËDIJËS KOMBËTARE.

1. Udhëheqësit intelektual.

2. Udheheqësit luftarak.

3. Kleriket bektashian.

4. Roli dhe kontributi i Kryegjyshit Dede Baba Edmond Brahimaj, në mbijetesën dhe perspektivat e bektashizmit si orientim kombëtar dhe fetar.

KREU I TRETË

Në kapitullin e tretë do të bëhet shpalosja e rezultatëve nga anketimi dhe intervistat me disa nga personalitet më të njohur bektashian sot. Qëllimi i këtij hulumtimi empirik për se gjithash është prezantimi i jetës bektashiane në trojet shqiptare në ditët e sotit, organizimi i tyre kombëtar dhe fetar, si dhe kontributi i komunitetit bektashian në ndërtimin e perspektivave kombëtare në të ardhmën më të afërmë dhe më të largmë.

1.1 PARAQITJA E BEKTASHIZMIT SI UDHE MISTIKE ISLAME.

*Ju lashe dy gjera pas meje, në se kapeni fort pas tyre, nuk do të humbisni asnjëherë .
Keto janë : Libri i Zotit, si një litar që zgjatët prej qiellit deri në toke dhe familja ime e
pastër e Ehli-Bejtit. Keto nuk ndahen asnjëherë nga njëra – tjetra,-
thenjë e Profeti Muhamed (s.a.s)*

Baba Selman Xhemali (kryetar i një prej teqeve të Elbasanit) kishte deklaruar: "*Bektashizmi s'është gjë tjetër veçse Islami i vërtetë, i mbështetur prej Kuranit*"⁴.

Islami (arab. ʾIslām) është një fe monotëistë abrahamike. Është e bazuar në besimin nënjë Zot (arab. Allahu), në zgjedhjen e Muhamedit për profetin e fundit, paracaktimin e fatit të njëjzve, shpërblimin për vepra të mira dhe dënimin për vepra të këqija, ditën e gjykimit dhe ringjalljen e të vdekurve. Kurani është shkrimi i shenjtë i Islamit dhe kështu burimi parësor i tij, i shkruar në gjuhën arabe dhe përmban 114 kapituj (sure). Burimi i dytë i Islamit janë fjalët dhe veprimet (synnëti) e profetit Muhamed. Qabeja, në Mekë, rajoni i Hexhazit, sot Arabia Sauditë, është qendra e Islamit. Myslimanënga e gjithë bota mbledhen këtu për tu falur në unitet.

Islami ndahet në dy drejtime besimi:

- **Sunit**: që besojnë Profetin Muhamed. Kuranin. Ebu Bekrin, Ibrahimin dhe Osmanin, të cilet janë kalifer shtëtor, hadifet e kuranit dhe të gjitha librat e shenjtë dhe

- **Shiit-ët**: besojnë Profetin Muhamed (a.s) Kuranin. Aliun. Fatimen . Hasanin Hysenin , Ehli Bejti është familja e Pejgamberit tonëtë dashur Muhamedit a.s. ndahen në dy dege

- Dega imamie : dega e 12 imameve.

- Dega zejdiye : e 7 imamve dhe mer një drejtim tjetër,

Bektashijtë i takojnë deges imamije, hyjnë në grupin alevijanë që i ka katër tarikatë:

-bektashijanë ,

-kalanderi,

-nihmetulli

⁴ "Kultura islame", përpjekja shqiptare, 11/12, Tiranë, maj 1938, f.295-296. Ky artikull, veç të tjerash, denigronte nivelin e ulët kulturor islamik shqiptar të kohës. Kjo vlejti që revista të ndalohej për 4 muaj prej Këshillit të Ministrave, për arsye të përzierjes në problemet fetare, kur ajo ishte veç një revistë kulturore.

-dhe xhelali.

Lavdia e Perendisë nuk shfaqët në atë që është e mundur në mënyrë njërëzore. Përkundrazi, besimi leviz në sferen e vetëdijes sonë, besimi fillon aty ku përfundon fuqia e njëriut.

"Ajo që për njërezit është e pamundshme, është për Zotin e mundshme"

Përsa i përket historisë fetare të religjionë ve të ndryshme , misticizmi kuptohet si një përvojë fetare që është e orientuar drejt "një tërësie realiteti" ose një realiteti të Perendisë. Përvojat mistike janë shprehur duke përdorur terma specifike të kontekstit, imazhe dhe fraza.

Termi mistër fillimisht u referohej vetëm doktrinë së fshehtë dhe kultit të fshehtë dhe më vonë në përgjithësi përdoret në kuptimin e diçkaje të errët dhe mistërieze.

Natyra e mendjes kuptohet si jo e dyfishtë. Megjithatë, kjo zakonisht është e pavetëdijshme dhe është e errësuar nga lidhja me egon. Nga kjo injorancë themelore vjen ideja e një ego ekzistuese të pavarur nga fenomenë t e tjera.

Përfaqësues të rëndësishëm të misticizmit islam janë :Haxhi Bektashi, Yunus Emre, Ghazali, Hafez, Shams-e Tabrizi, Ibn Arabi dhe Jalal ad-Din ar-Rumi. Në Islam ka urdhra të organizuar në urdhrat e quajtur sufiyya ose tasa'wuf. Të dy tërmat nganjëherë quhen "misticizëm", sepse në këtë kontekst institucional ka doktrina dhe praktika të ngjashme që shpesh lidhen me termin "misticizëm" në hapësirën kulturore perëndimore.

Mistika në kuptimin më të thelle nuk është një ceshtje vullnë ti por është një dhuratë një dhunti e cdo individi që e mbart me vetë.

Pasi njëriu deshmon dorzimin tek Zoti Fuqiplotë dhe ngrihet në pozicionin e adhurimit dhe të mbështetjes tek Ai, kërkesa e pare që kerkohet prej Krijuesit të tij, është udhezimi në rrugë të drejtë, në rrugën e pastër, në rrugën e drejtësisë dhe miresisë, në rrugën e Imamit dhe të veprave të mira.

Cdo periudhe kohore i ka të vecantat e saj, karakteristikat dhe kërkesat e veta.

Të gjitha keto e kanë pikënisjen tek situatat sociale dhe mendore të perhapura të asaj kohe.

Cdo kohë i ka problemet dhe paqartësitë e veta si rezultat të ndryshimit të sistemit, shoqërive dhe kulturave.

Misticizma në islam nuk është azgje tjetër vecse pasqyrë e gjallërise shpirtnore.

Bektashizmi si të gjitha rrugët mistike bazohet në njësinë e esences në botë.

Bektashizma është dogma mistike islame që meret me “persosmerinë e njëriut”.

Është rruga që e udheheq ndjekesin (besimtarin) dhe e shpie drejt në objektivin e dëshiruar, në afrimin me Zotin.

Bektashizma adhuron dhe respekton gjithë urdherë sat dhe veprimtaritë islame, baza e saj është kurani dhe fjala e Profetit Muhamed(a.s).

Bektashizma e mori këtë emer (pse, si institucion fetar, u organizua) u themelua nga i shenjtë Hunqar Piri Haxhi Bektash Veliu ,siq dihet e ka prejardhjen nga familja Profetike, është i biri i Ibrahimit të dytë, nipi i Musa Qazimit nga dymbedhjetë Imamet.

Bazat, parimet e bektashizmes, të vena nga Haxhi Bektashi Veliu, dhe të respektuara nga Ballen Sulltani dhe të gjithë pasardhesit e tij janë

- 1.) kurani dhe

- 2.) fjala e Profetit Muhamet (a.s),ku në cdo rregull, apo veprim, duhet që të respektohen.

Pastaj vjen Parimi tjetër;- ti kushtohet simpati dhe dashuri fjaleve të Profetit të madh Muhamet (a.s). Verseve të Kuranit, si dhe, familjes se Profetit (Ehli Bejti) Fatimja, Aliu, Hasani dhe Hyseni. Në baze të ketyre urdherave fetare, bektashijtë i ofrojnë një dashuri të madhe Aliut dhe familjes Profetike.

Një tjetër baze e bektashizmit është se feja islame është shkenca fetare e mbështetur mbi logjiken dhe arsyen.

Njëriu është qënder e gjithësisë dhe Zoti manifestohet në njëriun mbrenda tij.

Themeli i kesaj rruge në islam nuk është vetëm të plotësosh urdherë sat fetare ti lutësh Zotit etj. por duhet edhe të zbukurosh moralin, dhe ta lartësosh në nivelin e duhur.

Per atë bektashizmi shton se kur ti bejsh lutjet ndaj Zotit duhet edhe të kuptojsh lutjen. Lutja del nga shpirti, pra duhet edhe të kuptojsh fjalet që i shpreh. Lutja nuk është e sinqërtë dhe e dale nga shpirti kur lutësi nuk e mer vesh atë që thot. Lutja është e plotë që del nga zemra, lutja duhet bere në gjuhen amtare. Kjo është rruga e persosshmeris

1.2 PERHAPJA E BEKTASHIZMIT NË VISET SHQIPTARE

"Të besosh në Zot është të duash vellan e motren, shokun, atedheun dhe tere njerzimin"
Dede Reshat Bardhi⁵

Misionari i pare Bektashijan që shkeli token Shqiptare ka qenë Sarii Salltiku, i cili u vendos në Teqen e malit të Krujes. Teqeja ishte funksionale gjatë epopejes se lufterave të Arberve nen udheheqjen e Skenderbeut. Për habi edhe pse Skenderbeu ishte me rrenje krishtienë historianet e lidhin Skenderbeun edhe me bektashizmin. Nje tjeter personalitet shqiptar i madh që elistohet si Bektashian i madh ka qenë Ali Pashe Tepelena. Bektashijanet e tregojnë jo vetem, Tacin me 12 kulme që mbantë në koke, (nje simbolik që identifikon 12 imamet), shentoret bektashinj por edhe për sherbimet besimtare të ndryshme që i dallon nga tarikatet tjera dhe islami tradicional⁶.

Me kalimin e kohes bektashizmi u cerdhezua në trevat shqipfolese të Balkanit⁷. Shqiptaret e perqafuan masivisht besimin e rri, me sa dukej i pershtatej me mire realitetit historik dhe fetar të tyre. Ishtë nje besim që kishtë të benë me tolerancen, mirekuptimin dhe vellazerimin e shqiptareve. Pozicionohej larg radikalizmit të feve të tjera, shpesh here të dhunshme apo të drejtuara nga politika e kohes. Me sa dukej shqiptaret nisen ta gjejnë vetveten pikerisht tek besimi bektashijan. Është nje rruge që ka sherbyer edhe si ure bashkimi, është nje rruge në islam që nuk karakterizohet aspak nga fanatizmi dhe perjashtimi siq ndodh me ndonje besim tjeter.

Duke mos ndarë të njëjtën pikpamje me sunnitë vendas dhe të huaj, bektashit ë priren të nderojnë përveç Profetit Muhamed edhe familjen Profetike pra: Aliun, Fatimenë, Hasanin dhe Hysenin. Tarikati bektashian respekton të gjithë njerëzit pa dallim feje, ideje, race, ngjyre apo etnie. Besimtarët bektashinj falen në faltoret e tyre, burra dhe gra dhe njihen si motra dhe vëllezër. Në teqë vihet kur do besimtari dhe jo kur do kleriku.

⁵ **Haxhi Dede Reshat BARDHI** Intervistë me, më 15. Shtator 2009, në Tiranë.

⁶ **K.Sh.Tij. Haxhi Dede Edmond BRAHIMAJ** Intervist me Kryegjyshin Boterore ne Harabati Baba Teqe. 29 Korrik 2019 Tetove.

⁷ **Arben SULEJMANI**. Intervist, hulumtime dhe studime ne biblioteken familjare, nga 25-30 Korrik 2016.ne Raven, Gostivar.

Bektashianet duan çdo popull si shqiptarin e vet, por më tepër duan mëmëdhenë dhe mëmëdhetarët-shkruan poeti i madh i Rilindjes, Naim Frashëri.

Është fakt që shqiptarët, që në kohën e Hyjnizimit të Hynqar Haxhi Bektash Veliut u bënë përkrahës të tij. Mëndohet që në atë kohë, të paktën që në gjysmën e dytë të shek. XIV, misionarët e Hynqar Haxhi Bektash Veliut kanë përhapur idenë e bektashizmit në Shqipëri. Fryma e tolerimit, e dashurisë dhe e nderimit për të gjithë burrat dhe gratë, që janë krijuar sipas fytyrës së zotit dhe që janë shfaqje e tij pavarësisht racës, fesë apo kombësisë, dhe po kështu urrejtja për dyfytyrësinë, ndjenja e brendshme fetare, ndihma për njerëzit në nevojë, mirësjellja, ndershmëria, fryma e solidaritetit, barazisë, vëllazërisë, lirisë dhe demokracisë e të tjera si këto janë të gjitha mëszazhe që bektashinjtë përpiqën të përcjellin vazhdimisht si të vetmët tipare thelbësore të ideologjisë së tyre.⁸

Ky tarikat islam zhvillohej edhe në trojet lindore shqiptare, dikurë Kosova ose në trojet e Maqedonisë së sotme, filloi të depërtoj pothuajse mënjëherë pas themelimit, ose më së voni në gjysmën e dytë të shek.XIV. Sari Salltiku me plote dëshirë u pajtuar me propozimin e Hynqar Haxhi Bektash Veliut që të vintë në Ballkan⁹, për të përhapur tarikatin bektashian. Ai nga fundi i vitit 1338, vizitoi mjaft vende të Gadishullit Ballkanik, e në këtë kuadër edhe shumë qytetë shqiptare në trevat lindore, si: Manastirin, Ohrin, Shkupin, Mitrovicën, Sanxhakun etj.

Supozohet se pas Sari Salltëkut, në përhapjen e tarikatit Bektashi në trevat shqiptare, rol të madh luajti edhe heroi kombëtar Gjergj Kastriot – Skënderbeu, i cili këtë tarikat e përqafoi qysh si i rri në oborrin e sulltanit, kur ishte Jeniçer.

Gjithë ashtu, dihet se për një kohë, më një pjesë të trevave shqiptare sundontë edhe Ali Pashë Tëpelena. Një fakt është se e vetmja pasuri materiale e Ali Pashë Tëpelenës që ekziston në Muzeun Kombëtar është TAÇI i tij, Taç quhet Kurora ose kësula(religjioze) e Babait Bektashian.

⁸ Shih linkun: Bektashizmi në Shqipëri: histori politike e një lëvizjeje fetare [Bektashism in Albania: political history of a religious movement] (AIIS, 2008), shikuar më: 11.10.2019

⁹ Arben SULEJMANI, Ne arkivin e tije personal dokument te E.Bej.Vlora, në kujtimet e tij .

Në periudhën otomane, bektashijtë shqiptarë ndiqnin të njëjtat rregulla (rituale, besime, praktika) si gjithë bektashijtë e Perandorisë, që i përkisnin të njëjtit krah, dmth atij të Dede-Babave. Kujtojmë që për këtë krah, këto rregulla kanë qenë në pjesën më të madhe të fiksuara në fillim të shekullit 16, prej Pirit të dytë të Urdhërit, Balim Sulltan.

-Me gjithë keto edhe bektashizmi në Shqipëri nuk i shpetoi dot zemerimit të sulltan Mahmutit..Përveç veprimtarive të tjera të keqia emisaret e sulltan Mahmutit dogjen teqenë e baba Alikos në Berat se bashku me një bibliotekë të cmueshme që kishte. Djegja e kesaj teqeje sidomos e bibliotekës saj ishte një humbje e madhe për bektashizmin. Në këtë bibliotekë ndodheshin shume vepra të vlefshme , sidomos doreshkrime në arabisht dhe Persisht mbi filozofinë dhe misticizmin bektashian.Emisaret e sulltan Mahmutit dogjen edhe teqenë e Qoprilise në Manastir dhe teqenë e Melqanit në Korce. Grushti i sulltan Mahmutit kundër bektashizmit në Shqipëri ishte i rrende por edhe dëshira për Shqipëtarët për ta mbajtur gjalle bektashizmin ishte e forte. Kjo dëshirë bëri të mundur që bektashizmi të qëndroj në këmbë dhe të lulezoj në Shqipëri megjithëse me vonë u sundua nga sunduesit otoman.

Pasoja shume të renda bektashizmi përjetoi edhe gjatë luftërave Ballkanike.Gjate këtyre lufta baba e dervishë u shpërngulën më larg dhe u strukën në përfundim në rajonin e Vlorës, ashtu si edhe një pjesë e popullsisë së fshatrave të djegur. I tillë që rasti i Baba Ahmed Turanit (që drejtonte atëherë teqenë e Turanit pranë Tepelenës), ai u nis bashkë me dervishët e tij i shoqëruar prej popullsisë së fshatrave rrotull. Disa të tjerë lanë tokën shqiptare, si Baba Meleqi i teqesë së Shëmbërdhenjtit, Baba Shabani i teqesë së Prishtës dhe Baba Ahmedi i teqesë së Koshtanit. Këta dy të fundit gjetën strehim në Egjipt, në teqenë bektashiane të Kajros

Me vone teqetë u rindërtuan prej vetë babave e dervishëve, të ndihmuar prej besimtarëve. Problemi më i vështirë ishte gjetja e burimeve financiare. Për disa prej qëndrave, si ajo e Frashërit, Turanit (Tepelenë) dhe Asim Baba (Gjirokastrë) u kërkuar ndihmë pranë shqiptarëve të emigruar në SHBA. Disa dervishë u dërguan në kontinentin e ri për të mbledhur ndihmat e bashkëbesimtarëve të tyre me origjinë shqiptare¹⁰.

¹⁰ Kështu, Baba Kamberi, që ishte në këtë kohë dervish në teqenë e Frashërit, në 1916 u dërgua në SHBA për të gjetur ndihmat e nevojshme për rindërtimin e kësaj qëndre (Kallajxhi; 1964: f.l). Te. "Kalendari i

Fati i bektashizmit pas 1921 dallohej plotësisht nga ai i tarikateve të tjera shqiptare. Kjo për dy arsye, të dy të rëndësishme e të dyja të lidhura me rëndësinë numerike të masës së besimtarëve bektashianë. Së pari, bektashizmi u kthye në “komunitet ne vete” jashtë administartë të islamit sunit, duke u bërë një nga katër fetë e njohura në Shqipëri. Së dyti, komuniteti bektashian u përfshi prej një riorganizimi në rrafsh kombëtar, i përforcuar nga pikëpamja shpirtërore edhe prej ardhjes së “kryetarit botëror” që më parë ishte i vendosur në Turqi. Asgjë e këtij lloji nuk ndodhi me tarikatet e tjerë, të paktën deri më 1945, flinksiononin si urdhera mistike myslimane në gjirin e islamit sunit dhe sitonet e të cilëve (qëndrat kryesore) gjendeshin shpesh në territorin jugosllav, ndonjëherë edhe në Shqipëri, por këto tarikate nuk patën kurrë as karakter kombëtar të theksuar, as zotërim "universal" mbi qendrat e urdherave të tyre

Pra, tarikati bektashian dëshmoi se ishte besimi i duhur për shqiptarët. Bektashizmi fitoi statusin e një komuniteti që kerkoi pavaresinë e para, dhe sotë e meriton të jetë i barabart me komunitetet e tjera fetare shqiptare, nëpërmjet vendimeve të kongreseve bektashianenë vitet: 1921, 1924, 1929, 1945, si dhe Ligjit të Parë Mbi Komunitetet Fetare, 16 korik 1929, dekretuar prej Mbretit Zog, 8 gusht 1929, si dhe Ligjin e 26 nëntorit të vitit 1949. Për vlerat e tij kombëtare, gjatë periudhës së Zogut, besimi bektashian u propozua të kishtë statusin e një besimi kombëtar të shqiptarëve.

Në vitet 1930 - 1941, Kryegjyshi Salih Niazi Dede i dha bektashizmit në Shqipëri një dimension të ri historik dhe pasuroi dita - ditës traditën bektashianë të Haxhi Bektash Veliut që vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Lufta e dytë botërore që shtriu edhe Shqipërinë solli një varg ngjarjesh të hidhura për besimtarët bektashian, ku bektashianet e paguan shume shtrenjtë nacionalizmin e tyre.

Në 28 Nëntor 1941 në mënyrë misterioze u vra Kryegjyshi botëror Sali Njazi Dede. U vra së bashku me Dervishin e tij Azizin nga që nuk e pranoi pushtimin e Shqipërisë nga ushtria fashiste italiane. Nuk nënshkruajti kapitullimin e Shqipërisë.

Vatrës i Matit 1918”, i publikuar në Boston në 1918 gjendet një fotografi e Baba Kamberit, që në këtë periudhë mbante emrin Farfë (dervish) Kamber Frashëri (f.180).

Pas ndrim jetë të Kryegjyshit boteror Sali Nijazi Dede në krye të Kryegjyshates u vu baba Ali Riza Dede. Me vendosjen e sistemit Komunist serisht Bektashizmi u godit rende.¹¹ Në vitin 1947 Kryegjyshi boteror Dede Abazi zbrazti armen mbi dy baballenjve komunist baba faja amartaneshin dhe baba fejzon ata i kerkuar të riformontë urdherin bektashijan duke i kerkuan të lejohet martesë e klerikve.

-Në 1967 në kuader të ndertimit shtetit te pare ateist në botë, komunistet mbyllën dhe shkatruan edhe të gjitha objektet fetare bektashijane, dervishët dhe baballarët u xhveshën, dhe shumë të tjerë u burgosën dhe u persekutuan, rreth 65 klerikë bektashianë. Histeria e induktuar në popull germoi edhe varret e njerezve të shenjtë dhe hodhi tej arkivolet me eshtrat e tyre. Gjithsesi pati një vend ku bektashizmi mbijetoi, në SHBA në mendjen dhe në zemren e Baba Rexhepit¹².

Kur u mbyll feja në Shqipëri baba Rexhepi hapi Teqen e pare në SHBA në shtetin demokratik, por ajo që i dha puls dhe e ndihmoi me shume, ishte ndihma që ja dha Fan Noli i madh i cili në shume rastë vizitonte Teqenë bektashijanë keshtu që bashkatedhetaret duke pare se Fan Noli e vizitonte Teqenë ata u inkurajuan edhe me shume duke e kuptuar se Baba Rexhepi është një personalitet i lartë është një besimtar i paster dhe jo një tradhetar. Në teqen e Baba Rexhepit falen dhe i lutën Zotit jo vetem besimtarët bektashijan por edhe besimtarët e feve tjera katolike ortodokse dhe feve tjera. Pra feja bektashijanë është një fe Atedhe fe dhe Komb.

Në vazhdimësi, Baba Rexhepit iu shtuan katër dervishë: i pari ishte Dervish Arshiu i Vlorës, që vinte nga teqeja e Durballit në Greqi, ku kishte shkuar pasi kishte lënë Shqipërinë më 1949, pastaj Dervish Lutfiu i Gjirokastrës, që vinte nga teqeja e Kajros, ku shërbente që prej 1929; disa vite më vonë erdhën nga teqeja e Kajros, Dervish Bajrami, me origjinë nga Gjakova (Kosovë, Jugosllavi) dhe, së fundi Dervish Bektashi, që vinte nga Turqia, ku ishte bërë dervish prej Baba Sirriut të Kajros kur ai bëri një udhëtim në Turqi më 1954. Dervish Bajrami u emërua Baba prej Baba Rexhepit dhe

¹¹ **Arben SULEJMANI.** Intervist, hulumtime dhe studime ne biblioteken familjare, nga 25-30 Korrik 2016.ne Raven, Gostivar.

¹² **Arben SULEJMANI.** Intervist, hulumtime dhe studime ne biblioteken familjare, nga 25-30 Korrik 2016.ne Raven, Gostivar.

u caktua si zëvendësues i tij në krye të teqesë. Por Baba Bajrami vdiq pas pak kohësh.¹³

-Me 1990 pas lejimit të besimit, Baba Reshat Bardhi që kishtë mare bekimin e dede Ahmetit u be Apostulli i pare i ktij besimi. Ai ariti të ringjall bektashizmin, duke ringritur edhe të gjitha objektet nga germadhat e kultit. Në atë fillim të rindertimit të bektashizmit bektashizmin e bekon dhe e mirenjeh edhe shqiptarja e shenjtë Nenë Tereza duke ju ofruar edhe ndihmen e saj konkretë mori masa dhe e riktheu Kryegjyshaten boterore në atë gjendje si që ishte në koherat e meparshme.

Me urtesinë e nje besimtari të madh Baba Reshat Bardhi mblodhi të gjithë besimtarët në faltoret e vendeve të shenjta duke folur për besimin në të madhin Zot që vetem Zoti është nje dhe ska tjetër vec tij.

Mbas vitit 1990 me vendosjen e parimeve kryesore të demokratizimit të jetës sociale, politike dhe morale, janë ringritur 200 objektë të kultit bektashian në Shqipëri. Aktualisht drejtojnë teqet dhe dervishijet dhjetra baballarë dhe dervishë. Kryegjyshata Botërore Bektashiane është person juridik në bazë të së drejtës ndërkombëtare dhe të ligjit kushtetues të shtetit shqiptar. Ajo funksionon mbi bazën e parimit të centralizmit, të disiplinës së fortë e të ndërgjegjshme të klerit fetar dhe të punës drejtuese kolegjiale, bashkëpërgjegjësisë e vëllazërisë, në përputhje me statutin dhe rregullat kanonike bektashiane.

Në nëntor 2008 u nënshkrua marrveshja e shtetit shqiptar me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane¹⁴, si një nga komunitetet tradicional fetar në Shqipëri. Ajo ka dhënë e jep ndihmesë të çmuar në krijimin dhe pasurimin e tolerancës, bashkëjetesës, paqes sociale, qetësisë shpirtërore, urtësisë, harmonisë njerëzore, dialogut dhe respektimit ndërnjerëzor, kaq të nevojshëm dhe jetikë për vendin tonë dhe krejt rajonin. Bashkëpunimi i frutshëm ndërfaqet në Shqipëri si edhe mirëkuptimi midis feve është një mesazhi madh për botën e trazuar, një pasuri për njerëzimin.

¹³ Natali CLAIR. Shqiperia Vendi i Dervisheve 1990 Tirane, faq 378

¹⁴ **Arben SULEJMANI**. Intervist, hulumtime dhe studime ne biblioteken familjare, nga 25-30 Korrik 2016.ne Raven, Gostivar.

Në 2 prill të vitit 2011 ndërroi jetë Kryegjyshi Botëror i bektashinjve Haxhi Dede Reshat Bardhi, i cili do të kujtohet sidomos për kontributin e çmuar në vitet 1967-1990, si edhe në ringritjen e besimit në periudhën e pluralizmit politik shqiptar. Këshilli i Lartë Gjyshnor dhe Këshilli i Përgjithshëm zgjodhën më 10 qershor të vitit 2011 Haxhi Baba Edmond Brahimaj, i cili po vazhdon rrugën e Dede Reshatit. Në periudhën shtatëvjeçare të udhëheqjes së tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, përveç nismave në vazhdim të traditave më të vyera bektashiane, është pritur nga personalitetë të lartë fetarë dhe shtetërorë në SHBA, Francë, Turqi, Belgjikë, Zvicër, Irak, Itali, Papa Françesku, etj. Ai gëzon përkrahjen e komuniteteve bektashiane të kudondodhur në botë.

Sa I perket Maqedonise, gjegjesisht Republikes se Maqedonise se Veriut vlene te nenvizohet se gjatë viteve 1538-1548¹⁵ në Tetovë ngrehet Teqeja bektashiane nga Sersem Ali Dede e më vonë do të emërohet Harabati Baba¹⁶, qendër fetare, kulturore e arsimore e dëgjuar pranë godinave fetare islame dhe shkollave, siç ishin mektebet, medresetë, etj. Mirëbërësit e atëhershëm me ndihma të shumta dhe të ndryshme ndihmuan që edhe në kompleksin e Teqes Harabati të themelohet që me kohë një bibliotekë, e pasur dhe shumë e dëgjuar, e cila veproi në shekujt e kaluar, deri nga fillimi i shekullit të XX. Në atë kohë nga bibliotekat, si më e pasura veçohej e mirë njohura “Biblioteka e Teqes Harabati” aty veçojmë një antologji e përbërë prej pesë përmbledhjeve poezish nga Tetovari Sersem Ali Dede, një Baba Bektashian, vezir, filozof, teolog e poet i dëgjuar i kohës.¹⁷

¹⁵ **Arben SULEJMANI.** Intervist, hulumtime dhe studime ne biblioteken familjare, nga 25-30 Korrik 2016.ne Raven, Gostivar.

Arben, SULEJMANI. "A LIGHT OF GUIDANCE " *The Bektashi Community In the Balkans and around the World.* Tirana. Copyright 2015,

¹⁶ **K.Sh.Tij. Haxhi Dede Edmond BRAHIMAJ** Intervist me Kryegjyshin Boterore ne Harabati Baba Teqe. 29 Korrik 2019 Tetove.

¹⁷ **Arben, SULEJMANI.** KËRKIME HISTORIKE 4, Ndikimi i filozofisë bektashiane në zhvillimin e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të kombit tonë.SHKUP, 2011.f.274.

Bektashizmi ndër decenie ka qene dhe mbetet pjese perberese e jetes shpirtore te nje pjese te popullates shqiptare ne Kosove duke luajtur rol shume domethenes ne ngritjen edhe te vetedijes kometare.

Ne vitin 1790, Gjakoven e viziton nje kalender (njeri shpirtmire, jomaterialist) .Kalenderi gjeti konak ne teqene e sadive, ku sheh ne ate kohe ishte sheh Shemsi. Gjate kohes qe ndejti ne teqe Dervishi, foli per besimin ne udhen e Profetit te fundit dhe te Ehli Bejtit te tij¹⁸. Foli per njohurite qe e udhëheqin njeriun ne udhen e persosmerise dhe e paisin me te gjitha parimet morale duke e bashkuar me Zotin e Madh. Pas ketyre bisedimeve shehu ia dedikoi veten kurseve tona duke ecur drejt nje marëdhenje te plote dashurie dehese me Zotin. Pra, baba Shemsi eshte babai i pare ne teqene Gjakoves. Sherbei si baba prej vitit 1790 deri ne vitin 1820, ne kete vit ndrroi jete.

Pas kalimit te tij nga jeta, myhibanet e asaj kohe, bene kerkesen e zakonshme dhe kërkuan te birin e vellaut te babes Shems, Gani babain i cili edhe u be postnishin ne teqen e Gjakoves. Baba Gani, pastaj shtepine e vet dhe teqene i kthej ne pronesi te teqes bektashiane te Gjakoves. E qe aty e mbrapa teqeja thirrej me emrin, teqeja e Gani babait. Pas nje kohe ky shkoi me e vizitue mezarin e haxhi Bektash Veliut. Prej Haxhi Bektashit u kthye bashkë me dervish Haxhi Ademin. Kur mberrine ne Stamboll Gani Babai kaloi nga jeta .Ishte viti 1840.

Pas kalimit nga jeta e babes Hafiz në vitin 1927¹⁹, postnishin në Gjakove u emrua Haxhi Adem Vexh-hi Babai, që edhe ky kishtë lindur në Gjakove

Pastaj Baba u emrua Haxhi Hamza Babai, kishte lindur ne Gjakove.Ishte konsakruar bektashi ng Haxhi Adem Vexh-hi Babai. Heren e pare per dervish ka shkuar ne teqene e Sersem Ali Babait ne Tetove, dhe prej andej ne Leskovik²⁰. E me ne fund ka shkuar ne Haxhi Bektash ku edhe eshte emrua dervish prej Fejzi Dedeit.Disa kohe ka shërbye ne Haxhi Bektash. Edhe Haxhi Hamza Babai sikur shumica e dervishëve te asaj kohe ka vizituar te gjitha vendet e shenjta, si Meke, Medine, Nexhef, Qerbela, Bagdad,

¹⁸

¹⁹ Intervist **Baba Mumin LAME** Teqeja e Gjakovës. nga 01-03 Gusht 2016. Gjakovë.

²⁰ **K.Sh.Tij. Haxhi Dede Edmond BRAHIMAJ** Intervist me Kryegjyshin Boterore ne Harabati Baba Teqe. 29 Korrik 2019 Tetove.

Horosan, Bombai dhe Kairo. Ne Horosan ka ndejt një kohe të gjatë për arsye se nuk kishte më të holla. Pas një kohe shkon për vizite në Horosan Mahmut Shefki Baba dhe se bashku kthehen. Hamza Babai ka shërbye edhe në tyrben e Imam Ali Musa Rizait, ku edhe ka vazhduar mesimet neper medrese , dhe ka përfituar mjaftë në këte pikëpamje, pasi që i zotronte mirë edhe gjuhën persishte dhe arabishte. Pasi kaloi prej kësaj jete Haxhi Shyqri Babai që ishte postnishin i teqes së Ishtipit, myhibanet e kërkuan , që të emrohej Baba në atë teqe. Dekretin për Baba ia dha Fejzi Dedei dhe u bë postnishin i teqes së Ishtipit. Baba Hamza ka qëndruar aty deri në vitin 1942, atëherë teqeja u prish nga ushtria bullgare. Duhet të dimë se Baba Hamza ka shërbyer si Baba edhe në teqen e Gjakoves njëkohesisht, pas kalimit nga jeta e Haxhi Adem Vexh-hi Babait. Por prej vitit 1942 e deri në vitin 1946 Sherbei në teqen e Gjakoves.

Ka qenë njeri prej baballarëve që ishte studioz dhe kishte kulturë të lartë

E kishte një bibliotekë shumë të rëndësishme të cilën ia kishte dedikuar pasardhësit të tij Baba Qazimit²¹.

Baba Qazimi mesimet e para i mori në mektebin ruzhdie të Gjakoves, pastaj i vazhdoi në Shkup, në shkollën fetare “Darul Mualimine”, gjithashtu kreu edhe shkollën normale në fillim në Berat dhe e mbaroi në Elbasan. Në fillim punoi si mësues, në Shijak. Me vone u transferua në Qafë Zogaj. Kur princ Vidi u largua Baba Qazimi u detyrua të kthehet në Kosovë, dhe qëndroi shtatë-tetë muaj në Nikoliq të Hasit, dhe pas okupimit të Hasit u kthye në Gjakovë. Me vone Baba Qazimi u emrua sekretar në komunën e Bytyqit, pas një kohe u emrua edhe si krahinar. Në Bytyq mbeti deri sa iu imponua të organizoj ushtri vullnetare kundër Bajram Currit. Kjo kërkesë e detyroi të jepte dorëheqje. Me kërkesën e disa miqëve të tij shkoi në fshatin Shtiqen për të hapë një shkollë të re. Gjatë gjithë kësaj kohe kishte lidhje të ngushta me Bajram Currin, dhe qeverinë e asaj kohe. Për këte edhe është burgosur në Krume dhe pastaj në burgun e Shkodrës ku ndejti pesë muaj. Ishte njeri nga anëtarët më aktiv të degës së Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës për Gjakovë e rrethine. Pas gjithë kësaj veprimtarie Baba Qazimi vendos përfundimisht që të ketë në objektin e tij udhën fetare, në Bektashizëm. Ishte ba myhib kohe me parë nga Haxhi Adem Vexh-hi Babai. Uniformën e dervishit ia dha në Fushe Krujë Haxhi Mehmet

²¹ **Arben SULEJMANI**. Intervist, hulumtime dhe studime në bibliotekën familjare, nga 25-30 Korrik 2016 në Raven, Gostivar.

Babai. Rregullin e virgjerise nga Sali Nijazi Dedei. Nje kohe ishte dervish ne Shkoder ne sherbim te Baba Hajdar Stambollit. Nga Shkodra ka shkuar ne Elbasan ne teqen e Xhefai Ibrahim Babait.

Ne tetor te vitit 1941 Kryegjyshi Botëror Salih Nijazi Dedej e urdhëroi Dervish Qazimin per me shkue dhe me hap teqen e Tetoves dhe me u kujdes per pasurine e saje. Bashk me te shkoi edhe Dervish Musa. Disa kohe me vone Kryegjyshi botetrorë Sali Nijazi Dedei e emroi si Baba postnishin ne teqen e Tetoves. Ne vitin 1946 u emrua Gjysh (Halife) nga kryegjyshi botetrorë Xhafer Dede Babai²². Ishte burgose edhe ne Maqedoni, pas tet muaj hetimesh u lirua si i pafajshem. Prej asaj kohe e deri sa pushoi se jetuari , jetoi ne teqen e Gjakoves. Ishte njeri me autoritet te madh per Kosoven dhe kishte shume adhures. Nga dora e Baba Qazimit kane dale shume dervish dhe baballarë. Disa prej tyre edhe sot e vizitojne mezarin e Baba Qazimit. Koha kur Baba Qazimi emroi dervish dhe baballarë, ishte ajo kohe kur bektashizmi nuk lejohej ne Shqiperi. Baba Qazimi ishte njeri i ditur, i kulturuar merrej edhe me shkrime dhe përkthime, gjithashtu kishte ndjenja te fuqishme atdhetare. Ne teqen bektashiane te Gjakoves mbështeti idene per biblioteken e veqant ku kishte deponuar edhe shume shkrime te tij. Nje dorëshkrim përkthim nga persishtja i Baba Qazimit ka shpetuar , ate e kishte pas ruajtur kritiku letrar Vehap Shita. Sot e kemi librin e botuar ne gjuhen shqipe “Divani i Shemsi Tabrizit”. Baba Qazimi kaloj nga jeta me 15 shkurt 1981²³.

Ajo që bektashinjtë e gjithë viseve të Kosovës²⁴, do kujtojnë për baba Qazimin, është pikërisht fakti që traditën bektashiane, ky e pasuroi me elementë të mistikës dhe urtësisë bektashiane të këtyre trevave.

Baba Mumini²⁵ eshte myhib i Baba Tajarit nga viti 1987²⁶, ndersa edhe Dervish i Baba Tajarit nga viti 1993. U emrua Baba nga Kryeshenjteria Haxhi Dede Reshati ne vitin 1996 si postnishin ne teqen e Gjakoves.

²² **K.Sh.Tij. Haxhi Dede Edmond BRAHIMAJ** Intervist me Kryegjyshin Botetrorë ne Harabati Baba Teqe. 29 Korrik 2019 Tetove.

²³ **Arben SULEJMANI.** Intervist, hulumtime dhe studime ne biblioteken familjare, nga 25-30 Korrik 2016.ne Raven, Gostivar.

²⁴ Intervist **Baba Mumin LAME** Teqeja e Gjakovës. nga 01-03 Gusht 2016. Gjakovë.

²⁵ Intervist **Baba Mumin LAME** Teqeja e Gjakovës. nga 01-03 Gusht 2016. Gjakovë.

Pervec obligimeve te besimit, teqeja e Gjakoves, ne kohen e regjimit te ashper serb, funksionoi edhe si shkolle per maturantat e gjimnazit te Gjakoves. Sherbei edhe si vend tubim per manifestimet e ndryshme historike. Ne kete teqe eshte mbajte edhe nje pervjetor i Lidhjes se Prizrenit. Me 7 maj 1999²⁷ teqeja e Gjakoves²⁸ eshte djegje nga ushtria serbe. Me e dhimbshmja ishte biblioteka ne te cilen kishte shume libra me vlere dhe shume dorëshkrime te baballarëve qe kishin shërbyer ne Gjakove. Me ndihmen e dashamireve te bektashizmit teqeja u ndertua e re. Edhe sot kryhen shërbimet fetare bektashiane.

